

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Blerje P/N dhe kontratë mirëmbajtje e sistemit të regjistrimit VCR RICHOCHE”
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 34933000-6 Pajisje navigimi; 38110000-9 Instrumenta lundrimi
- **Vlera e fondit limit:** 12,166,633 (dymbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albcontrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional: Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2019-2020-2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit

2.2.2 Bilancet e viteve (2019-2020-2021) miratuar nga organet perkatese shteterore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronikë", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata ku të ketë realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe pikës 4/b, nenit 40/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerisë.
- **ISO/ IEC 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerisë.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, ose ekuivalente me to.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil sipas Rregullores se Komisionit European EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë ne vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit dhe ne lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.

2.3.3 OE, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar, apo të tjere lejuar/certifikuar/autorizuar nga prodhuesi për sistemin VCR Ricochet. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit të Prodhuesit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të LPP: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimet Teknike për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit VCR Ricochet

PËRMBAJTJA

REGJISTRIMI I NDRYSHIMEVE TË DOKUMENTIT GABIM! SHENJA E REFERIMIT E PADEFINUAR.

PËRMBAJTJA 4

HYRJE GABIM! SHENJA E REFERIMIT E PADEFINUAR.

KONFIDENCIALITETI GABIM! SHENJA E REFERIMIT E PADEFINUAR.

1. TË PËRGJITHËSHME GABIM! SHENJA E REFERIMIT E PADEFINUAR.

1.1 GAMA E FURNIZIMIT GABIM! SHENJA E REFERIMIT E PADEFINUAR.

2. KËRKESAT TEKNIKE PËR MIRËMBAJTJEN 6

2.1. KËRKESA TË PËRGJITHËSHME PËR MIRËMBAJTJEN 6

2.2 PJESË PËRMIRËSUESE I SISTEMIT TË REGJISTRIMIT AUDIO VIDEO RICOCHET 7

2.3 PLANI I PRODHUESIT PËR VAZHDIMESINË E BIZNESIT NE KUSHTE TE VECANTA 7

SHTOJCA A: LISTA E PAISJEVE DHE SHËRBIMEVE 7

Hyrje

Sistemi VCR Ricochet i prodhuara nga kompania Jotron eshte sistem operacional i cili perdoret ne kontrollin e trafikut Ajror per regjistrimin e te dhenave zanore si dhe video te sistemeve opsionale ne perdorim te kontrolloreve te trafikut Ajror.

Ky sistem shërben per regjistrimin e komunikimeve zanore Ajer-Toke dhe Toke-Toke si dhe per regjistrimin e pamjeve visuelle te ekraneve ne perdorim nga kontrolloret e ACC dhe TWR. Ky sistem i jep mundesine Albcontrol dhe Safety te realizoje investigimin e ngjarjeve dhe incidenteve ne kontrollin e trafikut ajror ne hapsiren e Shqiperise.

Konfidencialiteti

I gjithë Informacioni i marrë nëpërmjet kësaj procedure është pronë e Albcontrol dhe ofertuesit nuk mund ta përdorin apo shpërndajnë tek të tretë përveçse për nevojat e përbushjes dhe plotësimit të ofertës së tyre.

Po kështu oferta e dorëzuar në Albcontrol do të trajtohet si konfidenciale dhe nuk do të shpërndahet tek të tretë jashtë Albcontrol-it.

1. Të Përgjithëshme

Mirëmbajtja e këtij sistemi në Albcontrol duhet të sigurojë vijueshmërinë e punës, rritjen e performancës së tij, ruajtjen e nivelit të SAFETY në Albcontrol dhe plotësimin e standarteve të ICAO-s. Kjo mirëmbajtje do të mbulojë pjesën software dhe hardware të këtij sistemi.

Bazuar në sa u përmenden më lart si dhe në rëndësinë e shërbimit të Albcontrol-it si kompani dhe rendesine ligjore dhe administrative te ketij sistemi në këtë mirëmbajtje do të reflektohen hapat për sa më poshtë:

1. Suport teknik (Help Desk)
2. Kontroll dhe vlerësim i sistemeve

1.1 Gama e Furnizimit

Ofertuesit do të ofrojnë shërbimet e mirëmbajtjes si vijon:

A- Sistemi VCR Ricochet

- 1- Suport Teknik 8/5 (Help Desk)
- 2- Vizitë në Albcontrol për kontroll të sistemit
- 3- Mirëmbajtje të programit (software)

1. Kërkesat teknike për mirëmbajtjen	
2.1. Kërkesa të përgjithëshme për mirëmbajtjen	
Nr i specifikimit	Specifikimi
2.1.1	Mirëmbajtja e ofruar Do Të mbulojë si pjesën e programit ashtu dhe atë të paisjeve të sistemeve. 1- Kontraktuesi i kesaj mirembajtjeje duhet te sjelle prane albcontrol Certifikaten e Mirembajtjes nga prodhuesi ne te cilen duhet te jene te detajuara te gjitha sherbimet e perfshira per periudhen kohore te kontrates
2.1.2	Suporti teknik do te jete 8/5 (help desk) 1- Në rast problemesh ose difektesh që mund të shfaqen kërkohet Shërbimi i Mbështetjes Teknike (Technical Support) duke përfshirë komunikimin me e-mail dhe thirrje telefonike gjatë 8 orëve 5 ditë të javës. 2- Ky shërbim do të kryhet nga specialistët e firmës prodhuese Jotron për problemet ose difektet që mund të shfaqen gjatë periudhës së kontratës me metoda te ndryshme komunikimi duke perfshire Telefon, email, aplikime nderfaqesim Web per ngritje Ticket apo cfare mund te ofroje shtese Jotron. 3- Kontraktori duhet te deklaroje personat e kontaktit specialiste te kompanise Jotron , adresat e email , nr telefoni ne dispozicion dhe llogari hyrje ne nderfqn e suport web per te ngritur Ticket ne kohe reale me vlefshmeri per te gjithë periudhen e kontrates.
2.1.3	Mirembajtja nepermjet suportit teknik do te kryhet: 1- Nepermjet instruksioneve qe do ti jepen stafit teknik te Albcontrol 2- Nepermjet lidhjes ne distance me sistemin nese eshte e aplikueshme.
2.1.4	Kontraktuesi do të kryejë një kontroll në vënd të sistemeve. 1- Nga ky kontroll do të gjenerohet një raport për gjëndjen e sistemit dhe performancën e tij i dorrezuar ne Albcontrol jo me vone se 14 dite pas vizites ne site. 2- Stafi i kompanise prodhuese Jotron qe do te kryeje mirembajtjen preventive vjetore ne Site duhet te jete i trajnuar dhe me eksperience ne aktivitetet teknike ne sistemet VCR ne sherbimin ajror. 3- Raporti i mbajtur do të firmoset nga të dy palët.
2.1.5	Kontrolli i performances se sistemit 1- Do te kryhet nepermjet nje vizite ne Albcontrol nga personel i prodhuesit 2- Nga kontrolli do te gjenerohet nje raport per testet e kryera ne sistem si dhe problemet qe jane gjetur
2.1.6	Për cdo gjetje (problem) të dalë nga kontrolli i sistemit probleme te cilat shkaktojne daljen e sistemit nga specifikimet kontraktuesi do të realizojë rregullimin e tij brënda periudhës së kontratës.
2.1.7	Metoda e riparimit te problemeve softwerike dhe hardware 1- Problemet e gjetura nga kontrolli i performances se sistemit do te zgjidhen brenda periudhes se kontrates. 2- Problemet qe do te shfaqen gjate periudhes se mirembajtjes do te zgjidhen nepermjet suportit teknik 3- Te gjitha problemet qe do te riparohen do te jene probleme qe shkaktojne daljen e sistemit nga specifikimet e tij.

	4- Pjeset hardware te sistemit te demtuara duhet te riparohen nga kontraktuesi pa kosto shtese te kontrates.
2.1.8	<p>Mirembajtja e programit vetem ne rastet kur problemi mund te zgjidhet nepermjet upgrade te software.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Prodhuesi dhe kontraktori duhet te njoftojne me email dhe me shkrim per update te nevojshme qe permiresojne performancen e sistemit. 2- Ne rastet e problemeve ne program te raportuara nga stafi i Albcontrol prodhuesi do ti jape Albcontrol software upgrade ose software patch te testuar brenda periudhes se kontrates. 3- Per cdo upgrade apo patch qe do ti kryhet sistemit si per rritje performance ashtu dhe per riparim te problemeve Kontraktuesi do te jape listen e problemeve qe do te riparohen apo permiresimet qe kryhen nga kjo nderhyrje shoqeruar me testet e plota te kryera nga prodhuesi ne fabrike. 4- Gjate Kryerjes se upgrade apo update te sistemit Prodhuesi ne varesi te rendesise se nderhyrjes duhet te suportoje ose kryeje proceduren e update me nje nga metodat si dhenia e instruksioneve, remote connection me sistemin ose me ardhje te stafit te specializuar ne Albcontrol.

2.2 Pjesë përmirësuese i sistemit të regjistrimit Audio Video Ricochet

2.2.1	<p>Kontraktuesi do te furnizoje kablllo DVI dual Link.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kabllot duhet te jene per ambjente te brendeshme dhe flexibel. 2- Gjatesia e kabllit duhet te jete 0.5m 3- Karakteristikat e kabllit duhet te plotesojne standartin e Dual Link DVI (bitrate, video signal capability) 4- Connectoret DVI te kabllit duhet te jene njeri krah Mashkull dhe krah tjetër Femer.
--------------	--

2.3 Plani i prodhuesit per Vazhdimesine e Biznesit ne kushte te vecanta

2.3.1	<ol style="list-style-type: none"> 1- Kontraktori/prodhuesi duhet te ndaje me Albcontrol planin e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit ne kushte te vecanta. Business Continuity Plan. 2- Kontraktori duhet te evidentojte metoden e punes dhe kriteret minimale te ofrimit te sherbimit ne raste te vecanta si psh pandemie, ndalim te levizjes ndershtetase, demtime te asetave apo infrastruktures per shkaqe madhore.
--------------	---

Shtojca A: Lista e paisjeve dhe shërbimeve

Nr.	Pershkrimi pjeseve/sherbimeve	Njesia	Sasia	Koha e kryerjes
A	Mirembajtja e sistemit VCR Ricochet			
1	Suport teknik 8/5 hardware dhe software	vit	1	
2	Kontroll i performances se sistemit	cope	1	
3	Kablllo Dual Link DVI	cope	15	